



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
KANCELARI

Nr. 209 prot.

Tiranë, më 29.05.2024

**Lënda:** Njoftim mbi rezultatin e verifikimit paraprak për pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”.

**Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**TIRANË**

**KËSHILLI I GJYKATËS**

Bazuar në Ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur” si dhe në shpalljen nr. 1035/2 prot., datë 05.03.2024 për pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin 1 (një) “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve” në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në përfundim të verifikimit paraprak në lidhje me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve” kandidati që plotëson kushtin për fazën e dytë, atë të vlerësimit me shkrim nga Komisioni i Pranimit, është:

- Gjet Fufi.

Vlerësimi i kandidatit nga Komisioni i Pranimit do të jetë më datë **03.05.2024, ora 11:00** në Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rruga “Ismail Qemali” nr. 9, Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë.

KANCELARI  
Leonard STRATAJ

